

Para	SKK 1 “KUADRI I PËRGJITHSHËM PËR PËRGATITJEN E PASQYRAVE FINANCIARE” – PËRDITËSUAR (2023)
	OBJEKTIVAT DHE BAZA E PËRGATITJES
1	Objektivi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 1 <i>Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare</i> , SKK1, miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga ministri përgjegjës për financat, është të japë parimet bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare si dhe konceptet dhe rregullat-bazë për zbatimin e politikave kontabël, të vlerësimeve, të korrigjimit të gabimeve dhe paraqitjen e ngjarjeve ekonomike, pas datës së mbylljes së pasqyrave financiare të përgatitura në bazë të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit bazohen në parimet e kontabilitetit dhe të raportimit financiar të pranuar në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të cilave përshkruhen në Ligjin për kontabilitetin.
2	Kërkesat e SKK 1 korrespondojnë me paragrafë të veçantë të SNRF-ve për NVM (2015). Standardi bazohet kryesisht në Seksionin 2 - <i>Konceptet dhe Parimet e Përhapura Gjerësisht</i> . Standardi gjithashtu mbështetet në Seksionin 10 – <i>Politikat Kontabël, Vlerësimet dhe Gabimet</i> dhe në Seksionin 31 - <i>Ngjarjet pas Periudhës Raportuese</i> . Krahasimi i SKK 1 me SNRF për NVM-të (2015) është dhënë në paragrafin 125. Për rastet që nuk janë trajtuar nëpërmjet një politike të veçantë kontabël të SKK 1, drejtuesit e njësisë ekonomike raportuese duhet të miratojnë një politikë të tillë që siguron një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të mjeteve monetare të njësisë ekonomike, siç kërkohet në Ligjin për Kontabilitetin.
3	Pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e konceptit të materialitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit nuk zbatohen për zërat jomaterialë. Parimi i materialitetit përkufizohet dhe sqarohet në paragrafët 64 deri 68 të SKK 1. Pasqyrat financiare ndërtohen bazuar në supozimet bazë, parimet dhe karakteristikat e informacionit kontabël.
	FUSHA E ZBATIMIT
4	Kërkesat e SKK 1 “Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare”, do të zbatohen në të gjitha pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. ¹
	OBJEKTIVI I PASQYRAVE FINANCIARE
	Objektivi
5	Objektivi i pasqyrave financiare të përgatitura sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit është dhënia e informacionit rreth pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të mjeteve monetare të njësisë ekonomike, të dobishëm për vendimmarrjen ekonomike të një grupi të gjerë përdoruesish të cilët nuk kërkojnë raporte të veçanta për të përmbushur nevojat e tyre specifike për informacion.
6	Paraqitja e vërtetë dhe e besueshme nënkupton që: (a) parimet-bazë dhe kërkesat e tjera, të paraqitura në Ligjin e Kontabilitetit si dhe paragrafët 37-86 të standardit, janë përdorur si bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare; (b) aktivet, detyrimet, kapitali, të ardhurat, shpenzimet dhe fitimi neto, të paraqitura në pasqyrat financiare, përmbushin kriteret e përkufizimeve të dhëna në këtë standard.
7	Zbatimi me korrektësi i të gjitha Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit në përgatitjen e pasqyrave financiare, në përgjithësi jep një pamje të vërtetë e të besueshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të mjeteve monetare të njësisë ekonomike. Në raste shumë të rralla, kur drejtuesit e njësisë ekonomike mendojnë se zbatimi i SKK-ve të caktuara nuk bën të mundur dhënien e një pamje të vërtetë e të besueshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të mjeteve monetare të njësisë, atëherë drejtimi do të përgatisë pasqyrat financiare, sipas atyre parimeve që bëjnë të mundur një paraqitje të vërtetë e të besueshme dhe do të shpjegojë arsyet për moszbatimin e SKK-ve, në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.
	Pozicioni Financiar
8	Pozicioni financiar i një njësie ekonomike është marrëdhënia e aktiveve, detyrimeve dhe kapitalit të saj në një datë të caktuar siç paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar. Këto përcaktohen si më poshtë: (a) një aktiv është një objekt ose e drejtë e kontrolluar nga njësia ekonomike si rezultat i ngjarjeve të kaluara, nga i cili pritet të rrjedhin përfitimet e ardhshme ekonomike tek njësia ekonomike; (b) një detyrim është një detyrim aktual i njësisë ekonomike që rrjedh nga ngjarje të shkuara, shlyerja e të cilit pritet të rezultojë në një dalje të burimeve nga njësia ekonomike; (c) kapitali i vet është interesi i mbetur në aktivet e njësisë ekonomike mbasi zbriten të gjitha detyrimet e saj.

¹ Parimet dhe përkufizimet e dhëna në SKK 1 janë kuadri i përgjithshëm për kuptimin e SKK-ve të tjera dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas SKK-ve.

9	Disa zëra që plotësojnë përkufizimin e një aktivi ose një detyrimi mund të mos njihen si aktive ose detyrime në pasqyrën e pozicionit financiar, sepse ato nuk plotësojnë kriteret për njohje, dhënë në paragrafët 13 deri 24. Në veçanti, pritshmëria që përfitimet e ardhshme ekonomike do të rrjedhin tek ose nga një njësi ekonomike, duhet të jetë mjaft e sigurt për të përmbushur kriterin e probabilitetit para njohjes së një aktivi ose detyrimi.
	Performanca
10	Performanca është marrëdhënia e të ardhurave dhe shpenzimeve të një njësie ekonomike gjatë një periudhe raportuese. Ky standard lejon njësitë ekonomike të paraqesin performancën në dy pasqyra financiare (një pasqyrë të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe një pasqyrë të të ardhurave gjithëpërfshirëse). Fitimi/humbja e vitit ose totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse përdoren shpesh si matës të performancës ose si bazë për vlerësime të tjera, të tilla si kthimi në investime ose fitimet për aksion. Të ardhurat dhe shpenzimet përcaktohen si vijon: (a) të ardhurat nënkuptojnë rritje të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës raportuese në formën e hyrjeve ose shtimeve të aktiveve, ose ulje e detyrimeve, që rezultojnë në rritje të kapitalit, përveç atyre që lidhen me kontributet nga investitorët e kapitalit; (b) shpenzimet janë zvogëlimet në përfitimet ekonomike gjatë periudhës raportuese në formën e daljeve ose pakësimit të aktiveve ose si shtim të detyrimeve që rezultojnë në ulje të kapitalit, përveç atyre që lidhen me shpërndarjet për investitorët e kapitalit.
11	Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve rezulton direkt nga njohja dhe matja e aktiveve dhe e detyrimeve.
	PËRKUFIZIMET KRYESORE PËR ELEMENTET E PASQYRAVE FINANCIARE
12	Aktivët, detyrimet, kapitali, të ardhurat, shpenzimet dhe fitimi, të paraqitura në pasqyrat financiare, duhet të përmbushin kriteret e përkufizimeve të dhëna në këtë Standard. Kuptimet e këtyre përkufizimeve kryesore shpjegohen në paragrafët 13-35 të këtij Standardi.
	Aktivët
13	Aktivi është një objekt ose e drejtë ekonomike e kontrolluar nga njësi ekonomike: (a) që ka lindur si rezultat i ngjarjeve të shkuara; dhe (b) nga përdorimi i të cilit priten përfitime të ardhshme ekonomike.
14	Njësi ekonomike mund të marrë përfitime ekonomike nga aktivi në disa forma. Një aktiv mund të: (a) përdoret më vete ose i kombinuar me aktive të tjera për prodhimin e mallrave ose shërbimeve që shiten nga njësi ekonomike; (b) shkëmbehet me aktive të tjera; (c) përdoret për të shlyer/paguar një detyrim; (d) shpërndahet tek pronarët e njësisë ekonomike.
15	Shumë aktive të tilla si p.sh, aktivet afatgjata materiale, kanë përmbajtje fizike. Megjithatë, të qenurit fizik nuk është thelbësor për ekzistencën e tyre.
16	Bazë për raportimin e aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar është ekzistenca e pronësisë ligjore ose ekzistenca e kontrollit efektiv. Ndonëse në përgjithësi, kontrolli efektiv i aktiveve përputhet me pronësinë ligjore të tyre, kjo mund të mos ndodhë gjithmonë. Për shembull, në rastin e një marrëveshjeje për qira financiare, një aktiv mund t'i përkasë ligjërisht qiradhënësit, por meqenëse ky aktiv është nën kontrollin e qiramarrësit për pjesën më të madhe të jetës së dobishme të tij, aktivi raportohet në pasqyrën e pozicionit financiar të qiramarrësit.
17	Aktivi njihet në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike, vetëm nëse është e mundur që prej tij të gjenerohen përfitime ekonomike në të ardhmen. Nëse këto përfitime ekonomike janë të mundshme, por nuk ka siguri të mjaftueshme, ai aktiv nuk do të njihet në pasqyrën e pozicionit financiar. Një transaksion i tillë rezulton në njohjen e një shpenzimi në pasqyrën e performancës financiare. Megjithatë, aktive të tilla do të paraqiten në shënimet shpjeguese si aktive të kushtëzuara.
18	Vetëm ato aktive, kosto e të cilëve mund të përcaktohet me besueshmëri, njihen në pasqyrën e pozicionit financiar.
	Detyrimet
19	Detyrimet në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike janë detyrime aktuale të cilat:(a) kanë lindur nga ngjarje të shkuara; dhe (b) shlyerja e tyre pritet të shoqërohet me daljen e burimeve në të ardhmen.
20	Detyrimi njihet në pasqyrën e pozicionit financiar, nëse njësisë ekonomike, për të bërë shlyerjen e tij, do t'i duhet të veprojë në një mënyrë të tillë që do të shkaktonte dalje të përfitimeve ekonomike. Për shlyerjen e detyrimit, njësisë ekonomike mund t'i duhet, për shembull, të paguajë me parë ose ekuivalente të saj, të ofrojë një shërbim të caktuar, të japë një aktiv të caktuar, ta zëvendësojë atë detyrim me një detyrim tjetër ose ta shndërrojë detyrimin në kapital. Një detyrim gjithashtu mund të realizohet edhe me mjete të tjera, si p.sh, kur kreditori heq dorë ose e fal të drejtën e tij.
21	Shumë nga detyrimet vijnë nga marrëveshjet ligjore (të ashtuquajtura “detyrime kontraktuale”). Në raste të caktuara, detyrimet mund të lindin nga praktika ekonomike e njësisë ekonomike, si dhe nga dëshira për të mbajtur marrëdhënie të mira biznesi me klientët, punonjësit dhe partnerët e tjerë (të ashtuquajtura “detyrime konstruktive”).

	<p>Për shembull, nëse praktika ekonomike e një njësie ekonomike kërkon të bëhet zëvendësimi i të gjitha produkteve me defekt, njësia ekonomike do të njohë në pasqyrën e pozicionit financiar detyrimin që vjen nga kjo praktikë, pavarësisht nëse ekziston një detyrim ligjor ose jo.</p> <p>Një detyrim konstruktiv është një detyrim që rrjedh nga veprimet e një njësie ekonomike kur:</p> <p>(a) duke krijuar një model nga praktika e së kaluarës, nga politika të publikuara më parë ose deklarime specifike, njësia ekonomike u ka treguar palëve të tjera se ajo do të pranojë përgjegjësitë e veçanta, dhe</p> <p>(b) si rezultat, njësia ekonomike u ka krijuar një pritshmëri të arsyeshme palëve të tjera se ajo do t'i përmbushë këto përgjegjësi.</p>
22	<p>Një njësi ekonomike do të njohë një detyrim në pasqyrën e pozicionit financiar kur:</p> <p>(a) njësia ekonomike ka një detyrim në fund të periudhës raportuese, si rezultat i një ngjarje të kaluar;</p> <p>(b) është e mundur që njësisë ekonomike do t'i kërkohej transferimi i burimeve (që përfshijnë përfitime ekonomike) në shlyerje;</p> <p>(c) shumat e shlyerjes mund të matet me besueshmëri.</p>
23	<p>Një detyrim i kushtëzuar është një detyrim i mundur por i pasigurt, ose një detyrim aktual që nuk është njohur për shkak se ai nuk arrin të përmbushë një ose të dy kushtet (b) dhe (c) në paragrafin 22. Një njësi ekonomike nuk do të njohë një detyrim të kushtëzuar si një detyrim në pasqyrën e pozicionit financiar, me përjashtim të detyrimeve të paparashikuara të një blerje në një kombinim biznesi (shih SKK 9 <i>Kombinimet e Bizneseve dhe Konsolidimi</i>).</p>
	Kapitali i vet
24	Kapitali i vet (ose "aktivet neto") është diferenca mes aktiveve dhe detyrimeve të njësisë ekonomike në datën e pasqyrës së pozicionit financiar.
25	Aktivitet, detyrimet dhe kapitali i njësisë ekonomike paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar të kësaj njësie ekonomike në datën e raportimit.
	Të Ardhurat
26	Të ardhurat përfaqësojnë flukse hyrëse (rritjen e përfitimeve ekonomike) gjatë periudhës së raportimit, që çojnë në rritjen e aktiveve ose pakësimin e detyrimeve, si dhe që rrisin kapitalin e njësisë ekonomike, duke përjashtuar këtu ato që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital.
27	<p>Përkufizimi i të ardhurave përfshin si të ardhurat edhe diferencat (+):</p> <p>(a) të ardhurat lindin në rrjedhën e aktiviteteve të zakonshme të njësisë ekonomike dhe përmenden në një shumëllojshmëri emrash, duke përfshirë shitjet, tarifatat, interesin, dividendët, honoraret dhe qiratë;</p> <p>(b) diferencat (+) janë zëra të tjerë që plotësojnë përkufizimin e të ardhurave, por nuk janë të ardhura që ndikojnë tek fitimi/ humbja i/e vitit. Kur këto diferenca njihen në pasqyrën e performancës financiare, ato paraqiten veças (si të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse) sepse njohja e tyre është e dobishme për marrjen e vendimeve ekonomike.</p>
28	Njohja e të ardhurave rezulton direkt nga njohja dhe matja e aktiveve dhe detyrimeve. Një njësi ekonomike duhet të njohë të ardhurat në pasqyrën e performancës financiare kur lind një rritje në përfitimet e ardhshme ekonomike që lidhet me një rritje në një aktiv ose ulje të një detyrimi, e cila mund të matet me besueshmëri.
	Shpenzimet
29	Shpenzimet janë flukse dalëse (pakësimet e përfitimeve ekonomike) gjatë periudhës raportuese që rezultojnë në pakësimin e aktiveve apo rritjen e detyrimeve dhe që zvogëlojnë kapitalin e njësisë ekonomike, duke përjashtuar këtu ato që lidhen me shpërndarjet të pjesëmarrësit e kapitalit.
30	<p>Përkufizimi i shpenzimeve përfshin shpenzimet që lindin në rrjedhën e aktiviteteve të zakonshme të njësisë ekonomike po ashtu edhe diferencat (-):</p> <p>(a) shpenzimet lindin në rrjedhën e aktiviteteve të zakonshme të njësisë ekonomike dhe përfshijnë, për shembull, koston e shitjeve, pagat dhe amortizimin. Ato zakonisht marrin formën e një fluksi dalës ose pakësimit të aktiveve të tilla si paraja dhe ekuivalentët e saj, inventari ose aktivet afatgjata materiale;</p> <p>(b) diferencat (-) janë zëra të tjerë që plotësojnë përkufizimin e shpenzimeve dhe mund të lindin në rrjedhën e aktiviteteve të zakonshme të njësisë ekonomike por nuk ndikojnë tek fitimi/ humbja i/e vitit. Kur këto diferenca (-) njihen në pasqyrën e performancës financiare, ato paraqiten veças (si shpenzime të tjera gjithëpërfshirëse) sepse njohja e tyre është e dobishme për marrjen e vendimeve ekonomike.</p>
31	Njohja e shpenzimeve rezulton direkt nga njohja dhe matja e aktiveve dhe detyrimeve. Një njësi ekonomike duhet të njohë shpenzimet në pasqyrën e performancës financiare kur lind një ulje në përfitimet e ardhshme ekonomike që lidhet me një pakësim të një aktivi ose rritje të një detyrimi, e cila mund të matet me besueshmëri.
32	Të ardhurat dhe shpenzimet përfshijnë si të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara ashtu edhe ato të përcaktuara. Për shembull, të ardhurat e realizuara janë të ardhurat e njohura nga shitja e mallrave. Të ardhurat e përcaktuara p.sh. janë diferencat e njohura nga përkthimi i aktiveve ose detyrimeve monetare të mbajtura në monedhë të huaj.
	Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe fitimi /humbja
33	Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse është diferenca aritmetike ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, të realizuara dhe atyre të përcaktuara. Ky nuk është një element i veçantë i pasqyrave financiare dhe nuk është i nevojshëm një parim njohjeje i veçantë për të.

34	Fitimi ose humbja është diferenca aritmetike ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara (përveç atyre zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve që ky Standard i klasifikon si zëra të pasqyrës së të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse). Ky nuk është një element i veçantë i pasqyrave financiare dhe nuk është i nevojshëm një parim njohjeje i veçantë për të.
35	Ky Standard nuk lejon njohjen e atyre zërave në pasqyrën e pozicionit financiar, të cilët nuk plotësojnë përkufizimin e aktiveve ose detyrimeve, pavarësisht nëse ato rezultojnë nga zbatimi i konceptit të njohur si "koncepti i përputhshmërisë" për matjen e fitimit ose humbjes.
	PARIMET BAZË PËR PËRGATITJEN E PASQYRAVE FINANCIARE
36	Ligji për Kontabilitetin përcakton parimet-bazë për mbajtjen e kontabilitetit dhe përgatitjen e pasqyrave financiare, në përputhje me këtë ligj, si dhe me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, publikuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit. Paragrafët 37 deri 86 të këtij standardi përshkruajnë këto parime-bazë. Asnjë nga paragrafët e këtij seksioni (paragrafët 37 deri 86) nuk kanë përparësi ndaj ndonjë kërkesë specifike të paragrafëve të tjera të SKK 1 ose të ndonjë SKK-je tjetër.
	Supozime dhe konsiderata të përgjithshme
	Konstatimi i të drejtave dhe detyrimeve dhe përputhshmëria
37	Me qëllim që të përmbushin objektivat e tyre, pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Sipas kësaj metode, efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera njihen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin (dhe jo kur paraaja ose ekuivalentet e saj arkëtohen ose paguhen) dhe njihen në kontabilitet e raportohen në pasqyrat financiare të periudhave kontabël, të cilave u përkasin.
38	Shpenzimet që lidhen me të ardhurat e fituara gjatë periudhës raportuese njihen në të njëjtën periudhë kontabël si dhe të ardhurat përkatëse. Shpenzimet e kryera gjatë një periudhe raportuese, që ndryshon nga periudha kur ato i sjellin përfitime njësisë ekonomike, regjistrohen si shpenzime pikërisht në periudhën kur merren përfitimet.
39	Nëse të ardhurat që lidhen me shpenzime të caktuara, nuk mund të përcaktohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, atëherë për njohjen e tyre do të përdoren mënyra të tërthorta. Për shembull, shpenzimet që lidhen me blerjen e një aktivi afatgjatë material njihen si shpenzime gjatë jetës së dobishme të këtij aktivi (shpenzimet e amortizimit). Shpenzimet, që nuk priten të gjenerojnë të ardhura, njihen si shpenzime në momentin kur ato ndodhin.
	Parimi i njësisë ekonomike
40	Njësia ekonomike mban llogari të aktiveve, detyrimeve dhe transaksioneve ekonomike të veta të veçanta nga ato të aktiveve, detyrimeve dhe transaksioneve ekonomike të aksionarëve, kreditorëve, punonjësve, klientëve si dhe personave të tjerë.
41	Vetëm aktivet, detyrimet, kapitali, të ardhurat, shpenzimet dhe flukset e mjeteve monetare të njësisë ekonomike do të paraqiten në pasqyrat e saj financiare. Përveç transaksioneve të saj ekonomike, pasqyrat e konsoliduara të njësisë ekonomike do të përfshijnë edhe transaksionet ekonomike të njësisë që ajo kontrollon.
	Parimi i vijimësisë
42	Pasqyrat financiare përgatiten sipas parimit të vijimësisë, që do të thotë se veprimtaria ekonomike e njësisë ekonomike do të ketë vijimësi dhe njësia ekonomike nuk ka në plan ose nuk do ta ketë të nevojshme ta ndërpresë aktivitetin e saj. Nëse pasqyrat financiare nuk përgatiten në përputhje me parimin e vijimësisë, parimi tjetër kontabël i përdorur për përgatitjen e tyre, duhet të sqarohet në shënimet shpjeguese.
43	Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, drejtuesit duhet të vlerësojnë mundësinë e njësisë ekonomike për të vazhduar aktivitetin e saj për 12 muaj pas datës së pasqyrave financiare. Nëse kjo vazhdimësi aktivitetesh të njësisë ekonomike nuk është e sigurt (për shembull, njësia ekonomike nuk i plotëson kërkesat ligjore), drejtuesit e njësisë ekonomike duhet të sqarojnë në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, kushtet dhe rrethanat që e shkaktojnë këtë pasiguri. Nëse njësia ekonomike ka filluar procesin e likuidimit ose është e mundur që brenda 12 muajve të ardhshëm njësia ekonomike do ta likuidojë ose do t'i duhet që ta likuidojë aktivitetin e saj, atëherë pasqyrat financiare duhet ta reflektojnë këtë fakt si dhe bazën e vlerësimit të aktiveve dhe detyrimeve.
	Njohja e aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve
44	Njohja është procesi i përfshirjes në pasqyrat financiare, të një zëri që plotëson përkufizimin e një aktivi, detyrimi, të ardhure ose shpenzimi dhe që plotëson kriteret e mëposhtme: (a) është e mundur që çdo përfitim ekonomik në të ardhmen, lidhur me këtë zë, do të rrjedhë për ose nga njësia ekonomike; dhe (b) zëri ka një kosto ose vlerë që mund të matet me besueshmëri.
45	Gabimet në njohjen e një zëri që përmbush këto kriteret nuk korrigjohen në shënimet shpjeguese mbi politikat kontabël të përdorura apo në sqarime të tjera të mëtejshme.
	Probabiliteti i përfitimit të ardhshëm ekonomik
46	Koncepti i probabilitetit, si kriteri i parë i njohjes, i referohet shkallës së pasigurisë që përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me një zë të caktuar, do të rrjedhin tek ose nga njësia ekonomike. Vlerësimet e shkallës së pasigurisë të flukseve të përfitimeve të ardhshme ekonomike, kryhen mbi bazën e evidencës së kushteve të

	disponueshme në fund të periudhës raportuese, në kohën e përgatitjes së pasqyrave financiare. Këto vlerësime kryhen individualisht për zërat individualisht të rëndësishëm dhe në grup për zëra individualisht të parëndësishëm.
	Besueshmëria e matjes
47	Kriteri i dytë për njohjen e një zëri është që kosto ose vlera që ai ka të mund të matet me besueshmëri. Në shumë raste, kosto ose vlera e një zëri njihet. Në raste të tjera kosto duhet të vlerësohet. Përdorimi i vlerësimeve të arsyeshme është një pjesë thelbësore e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe nuk dëmton besueshmërinë e tyre. Zëri nuk njihet në pasqyrat financiare, në rastet kur nuk mund të kryhet një vlerësim i arsyeshëm.
48	Një zë që nuk arrin të përmbushë kriteret e njohjes mund të kualifikohet për njohje në një datë të mëvonshme, si rezultat i rrethanave ose ngjarjeve të mëvonshme.
49	Një zë që nuk arrin të përmbushë kriteret e njohjes, mund megjithatë të paraqitet në shënimet shpjeguese ose në materiale të tjera shpjeguese. Kjo ndodh kur njohja e zërit ka rëndësi për vlerësimin e pozicionit financiar dhe performancës financiare të një njësie ekonomike nga përdoruesit e pasqyrave financiare.
50	Transaksionet me aksionet e veta të njësisë ekonomike (të quajtura edhe "aksionet e thesarit") përfaqësojnë shpërndarjet e bëra për aksionarët e njësisë ekonomike ose kontributet e marra nga aksionarët e njësisë ekonomike, si rezultat i të cilave ato nuk bien nën përkufizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve. Prandaj, transaksione të tilla nuk do të njihen si të ardhura e as si shpenzime në pasqyrën e performancës financiare, por si një transaksion kapitali në pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin e vet.
51	Matja është procesi i përcaktimit të shumave monetare me të cilat një njësi ekonomike mat aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet, në pasqyrat e saj financiare. Matja përfshin zgjedhjen e një baze të matjes. Ky standard specifikon cilën bazë të matjes një njësi ekonomike duhet të përdorë për lloje të ndryshme të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve.
52	Dy bazat e zakonshme të matjes janë kosto historike dhe vlera e drejtë: (a) për aktivet, kosto historike është shuma e mjeteve monetare ose ekuivalentëve të mjeteve monetare të paguara ose vlera e drejtë e shumës së dhënë për të blerë aktivin në momentin e përfuturit të tij. Për detyrimet, kosto historike është shuma e mjeteve monetare (apo ekuivalentëve të mjeteve monetare) ose vlera e drejtë e aktiveve jo-monetare të marra në këmbim për detyrimin në kohën e lindjes së këtij të fundit, ose në disa rrethana (për shembull, tatimi mbi të ardhurat) shuma e mjeteve monetare ose ekuivalentëve të mjeteve monetare që pritet të paguhet për të shlyer detyrimin në rrjedhën normale të biznesit. Kostoja historike e amortizuar është kostoja historike e një aktivi ose detyrimi plus ose minus atë pjesë të kostos së tij historike njohur më parë si shpenzim ose e ardhur. (b) vlera e drejtë është çmimi që do të pranohej për të shitur një aktiv ose që do paguhej për të shlyer një detyrim, në një transaksion të zakonshëm midis pjesëmarrësve të tregut, në datën e matjes.
53	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit mund të përcaktojnë baza të tjera matjeje kur këto konsiderohen si më të përshtatshme nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit.
	Njohja dhe matja fillestare
54	Matja fillestare e aktiveve dhe detyrimeve që plotësojnë kriterin e njohjes, bëhet me koston historike, përveç rasteve kur ky Standard kërkon matje fillestare mbi një bazë tjetër të tillë si vlera e drejtë.
	Vlerësimi i mëpasshëm
55	Një njësi ekonomike mat aktivet dhe detyrimet financiare, ashtu siç përcaktohet në SKK 3 – <i>Instrumentet financiare</i> .
56	Shumica e aktiveve jo-financiare të një njësie ekonomike fillimisht njihen me kosto historike dhe më pas maten mbi baza të tjera të matjes. Për shembull: (a) një njësi ekonomike vlerëson aktivet afatgjata materiale me koston e amortizuar (ose vlerën e drejtë si një alternativë e lejuar në SKK 5 – <i>Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale</i>); (b) një njësi ekonomike vlerëson inventarët me vlerën më të ulët mes <i>kostos</i> dhe <i>çmimit të shitjes minus koston për të përfunduar shitjen</i> ; (c) një njësi ekonomike njih një humbje nga zhvlerësimi në lidhje me aktivet jo-financiare që janë në përdorim ose mbahen për shitje; Vlerësimi i aktiveve me më të voglën mes dy vlerave, ka për qëllim të sigurojë që një aktiv nuk është vlerësuar me shumë sesa vlera që njësi ekonomike pret të rikuperojë nga shitja ose përdorimi i atij aktivi.
57	Shumica e detyrimeve, përveç detyrimeve financiare, maten me vlerësimin më të mirë të mundshëm të parashikuar që kërkohet për të shlyer detyrimin në datën e raportimit.
	Kompensimi
58	Aktivët / detyrimet dhe të ardhurat / shpenzimet nuk kompensohen me njëra-tjetrën, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë kërkohet ose lejohet nga një standard kombëtar i kontabilitetit.
59	Është e rëndësishme që aktivet dhe detyrimet, si dhe të ardhurat e shpenzimet të raportohen më vete. Kompensimi në pasqyrën e performancës financiare ose në pasqyrën e pozicionit financiar, përveç rasteve kur ai e reflekton më mirë përmbajtjen e transaksionit ose ngjarjes, e pakëson aftësinë e lexuesit si për të kuptuar transaksionet, ngjarjet dhe kushtet që kanë ndodhur, ashtu edhe për të vlerësuar flukset e ardhshme të mjeteve monetare.

	Karakteristikat cilësore të pasqyrave financiare
60	Karakteristikat cilësore janë ato që e bëjnë informacionin e pasqyrave financiare të dobishëm për përdoruesit. Karakteristikat cilësore kryesore janë: kuptueshmëria, rëndësia, besueshmëria, kohshmëria dhe krahasueshmëria.
	Kuptueshmëria
61	Informacioni në pasqyrat financiare duhet të paraqitet në mënyrë të tillë që ai të jetë informues dhe pa ekuivok për ata përdorues të pasqyrave financiare që kanë njohuri të mjaftueshme në fushën e kontabilitetit për të kuptuar pasqyrat financiare.
62	Pasqyrat financiare përgatiten për të informuar një grup të gjerë përdoruesish (përfshirë këtu aksionarët dhe kreditorët, punonjësit, partnerët në biznes, publikun në përgjithësi, institucionet shtetërore dhe të tjerët). Me qëllim që informacioni në pasqyrat financiare të jetë informues dhe sa më i kuptueshëm, terminologjia e përdorur duhet të jetë e njëjtë, përgjatë gjithë materialit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare duhet mbajtur parasysh fakti se ato duhet të jenë të qarta e të kuptueshme edhe për përdorues të jashtëm, të cilët mund të mos jenë në dijeni të aktiviteteve të përditshme të njësisë ekonomike. Prandaj, pasqyrat financiare duhet të përgatiten në mënyrë të tillë që ato ta shmangin përdorimin e një gjuhe ose terminologjie specifike të njësisë ekonomike, e cila mund të mos jetë e kuptueshme për lexuesit e jashtëm. Megjithatë, në përgatitjen e pasqyrave financiare mendohet që lexuesit e tyre duhet të kenë njohuri të përgjithshme të mjaftueshme në fushën e kontabilitetit, prandaj nuk është e nevojshme që pasqyrat financiare të shpjegojnë koncepte të përgjithshme financiare.
63	Nëse një informacion i të njëjtit transaksion shpjegohet në pjesë të veçanta të pasqyrave financiare, atëherë pasqyrat financiare duhet të përmbajnë referencat përkatëse. Për shembull, zërat e pasqyrës së pozicionit financiar, të pasqyrës së performancës financiare dhe të pasqyrës së fluksit të mjeteve monetare, duhet të përmbajnë referenca me shënime shpjeguese, të cilat paraqesin një informacion më të hollësishëm në lidhje me to. Nëse informacioni për të njëjtin transaksion ose informacion financiar sqarohet në dy shënime shpjeguese të veçanta, atëherë këto dy shënime duhet gjithashtu të kenë referencat përkatëse midis tyre.
	Rëndësia dhe Materialiteti
64	Pasqyrat financiare paraqesin të gjithë informacionin material që ndikon në pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare të njësisë ekonomike. Informacioni në këto pasqyra konsiderohet material, nëse mungesa ose pasaktësia në paraqitjen e tij do të ndikonte në vendimet ekonomike të përdoruesve të pasqyrave financiare. Zërat jomateriale mund të njihen duke përdorur metoda më të thjeshtuara.
65	Në përgatitjen e pasqyrave financiare rëndësi u duhet vënë atyre aspekteve dhe të dhënave financiare të aktiviteteve ekonomike që janë të rëndësishme për përdoruesit e pasqyrave financiare dhe që mund të ndikojnë në vendimet ekonomike që ata marrin. Rëndimi i pasqyrave financiare me hollësi të tepruara dhe informacion jomaterial dëmton qartësinë dhe kuptueshmërinë e tyre.
66	Në përcaktimin e materialitetit duhet të merren parasysh aspektet cilësore dhe sasiore të informacionit. Për transaksione të caktuara mund të ndodhë që shumat e vogla mund të kenë një rëndësi kuptimore më të madhe për përdoruesit se sa transaksione të tjera të zakonshme.
67	Manipulimi i qëllimshëm i shumave jomateriale, për të arritur një rezultat të caktuar financiar, është i ndaluar.
68	Për kontabilizimin dhe raportimin e zërave jomaterialë në pasqyrat financiare mund të përdoren metoda të thjeshtuara kontabël, për aq kohë sa rezultati nuk do të ndryshojë ndjeshëm, nga rezultatet që do të ekzistonin po të ishin zbatuar politikat kontabël të përshkruara nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.
	Besueshmëria
69	Informacioni i dhënë në pasqyrat financiare duhet të jetë i besueshëm. Informacioni është i besueshëm kur ai është i lirë nga gabimet materiale dhe paragjykimet si dhe kur përfaqëson me besnikëri atë që ai ka për qëllim të përfaqësojë ose që në mënyrë të arsyeshme pritet të përfaqësojë. Pasqyrat financiare konsiderohen të mos jenë pa paragjykim (dmth. nuk janë neutrale) nëse, nga zgjedhja ose paraqitja e informacioneve, ato kanë për qëllim të ndikojnë në marrjen e një vendimi ose gjykimi në mënyrë që të arrihet një rezultat apo përfundim i paracaktuar.
	Parimi i paraqitjes me besnikëri
70	Që të jetë i besueshëm informacioni, duhet të paraqesë me besnikëri transaksionet dhe ngjarjet e tjera, të cilat ai mundohet ose pritet që t'i paraqesë. Kështu, për shembull pasqyra e pozicionit financiar duhet të paraqesë me besnikëri transaksionet dhe ngjarjet e tjera që rezultojnë në krijimin e aktiveve, detyrimeve dhe kapitalit për njësinë ekonomike në datën e raportimit dhe që plotësojnë kriteret e njohjes.
	Parimi i përparësisë së përmbajtjes ekonomike mbi formën ligjore
71	Për regjistrimin e transaksioneve ekonomike në pasqyrat financiare merret në konsideratë përmbajtja e tyre ekonomike, e cila nuk është e thënë që të përputhet gjithmonë me formën e tyre ligjore.

72	Për regjistrimin e transaksioneve të biznesit nuk mbahet parasysh vetëm baza ligjore, mbi të cilën ato janë formuluar ose krijuar, por edhe përmbajtja e tyre ekonomike, e cila është e një rëndësie maksimale. Ndonëse në shumë raste përmbajtja ekonomike e transaksioneve të biznesit përputhet me formën e tyre ligjore, kjo nuk ndodh gjithmonë. Për shembull, marrëveshje të caktuara për qira financiare mund të quhen formalisht marrëveshje qiraje të zakonshme, por, nëse këto marrëveshje i plotësojnë kriteret e qirasë financiare të përshkruara në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit 7 <i>Kontabilizimi i qirave</i> , ato regjistrohen në pasqyrat financiare, si qira financiare.
	Parimi i paanshmërisë
73	Që të jetë i besueshëm informacioni i paraqitur në pasqyrat financiare, duhet të jetë i paanshëm, që do të thotë i painfluencuar. Pasqyrat financiare nuk konsiderohen të paanshme, nëse nga mënyra se si informacioni zgjidhet ose paraqitet ato influencojnë gjykimin apo marrjen e vendimit me qëllim për të arritur një rezultat të paracaktuar.
	Parimi i maturisë
74	Natyra dhe shkalla e pasigurisë, që në mënyrë të paevitueshme shoqëron ngjarje dhe rrethana të caktuara, paraqitet në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare dhe për pasiguritë kërkohet ushtrimi i parimit të kujdesit në përgatitjen e pasqyrave financiare. Parimi i kujdesit është përfshirja e një shkalle maturie në ushtrimin e gjykimeve të nevojshme në bërjen e vlerësimeve të kërkuara sipas kushteve të pasigurisë, të tilla që aktivet ose të ardhurat të mos mbivlerësohen dhe detyrimet ose shpenzimet të mos nënvlerësohen. Megjithatë, ushtrimi i kujdesit nuk lejon nënvlerësimin e qëllimshëm të aktiveve ose të ardhurave, ose mbi vlerësimin e qëllimshëm të detyrimeve ose shpenzimeve. Me pak fjalë, kujdesi nuk lejon paragjykime.
75	Në vlerësimet kontabël, drejtuesit e njësisë duhet ta shmangin optimizmin e tepruar. Përkundrazi, ata duhet t'i marrin në konsideratë të gjithë faktorët që mund të ndikojnë në vlerën e aktiveve dhe detyrimeve. Për shembull, për vlerësimin e zhvlerësimit për kërkesat e arkëtueshme të dyshimta, drejtuesit e njësisë ekonomike duhet të marrin parasysh përvojën e mëparshme, në lidhje me kërkesat e paarkëtuara, nuk duhet të mendojnë me optimizëm se gjendja është përmirësuar dhe rrjedhimisht, nuk është nevoja për ta zvogëluar vlerën kontabël të kërkesave të arkëtueshme për shkak të rënies së vlerës.
	Parimi i plotësisë
76	Pasqyrat financiare duhet ta japin të gjithë informacionin e nevojshëm për të paraqitur një pamje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe flukseve të mjeteve monetare të njësisë ekonomike.
	Kohshmëria
77	Për të qenë i rëndësishëm, informacioni financiar duhet të jetë në gjendje të ndikojë vendimet financiare të përdoruesve. Kohëshmëria përfshin sigurimin e informacionit brenda kufijve kohorë të vendimeve. Nëse ka vonesa të tepruara në raportimin e informacionit, ai mund të humbasë rëndësinë e tij. Drejtimi duhet të balancojë cilësitë relative të raportimit në kohë dhe sigurimit të informacionit të besueshëm. Në arritjen e një balance mes rëndësisë dhe besueshmërisë, duhet të merret në konsideratë sesa mirë mund të plotësohen nevojat e përdoruesve në marrjen e vendimeve ekonomike.
	Qëndrueshmëria dhe Krahasueshmëria
78	Për përgatitjen e pasqyrave financiare duhet të përdoren vazhdimisht të njëjtat politika kontabël, e njëjta paraqitje dhe të njëjtat formate të pasqyrave financiare.
79	Qëndrueshmëria në politikat kontabël dhe në formatin e paraqitjes së pasqyrave financiare, është e nevojshme për një krahasim objektiv të treguesve të performancës financiare të njësisë ekonomike në vite. Kërkesat standarde për politikat kontabël, formatet e paraqitjes së informacionit financiar si dhe informacioni që duhet paraqitur në pasqyrat financiare, përbëjnë bazën për krahasimin e të dhënave financiare të njësisë të ndryshme ekonomike.
	Të tjera karakteristika cilësore të pasqyrave financiare
	Balanca mes kostove dhe përfitimeve
80	Përfitimet që rrjedhin nga informacioni i pasqyrave financiare duhet të tejkalojnë kostot e sigurimit të tij. Vlerësimi i kostove dhe përfitimeve është në thelb një proces gjykimi.
	Kosto apo përpjekje e papërshtatshme
81	Në zbatimin e disa prej kërkesave të SKK-ve, lidhur me njohjen, matjen dhe vlerësimin e mëpasshëm, përcaktohen përjashtime në rastet kur për zbatimin e tyre kërkohen kosto apo përpjekje të papërshtatshme.
82	Zbatimi i një kërkese do të konsiderohej si kosto apo përpjekje e papërshtatshme nëse kostot shtesë (rritëse) ose përpjekjet shtesë do të tejkalojnë ndjeshëm përfitimet që do të merrnin nga informacioni i ofruar ata që pritet të përdorin pasqyrat financiare të NJVM-ve.
83	Ndryshimet në politikat kontabël shpjegohen në paragrafët 94-98 të këtij Standardi.
84	Paraqitja e informacionit (përfshirë këtu formatet e pasqyrës së pozicionit financiar, pasqyrës së performancës financiare, pasqyrës së fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrës së ndryshimeve në kapital) mund të ndryshojë, vetëm nëse: (a) ndryshimi kërkohet nga një standard i ri ose i përmirësuar, i miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ose nga Ligji “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”;

	(b)formati i ri jep një paraqitje më objektive e më të plotë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të mjeteve monetare të njësisë ekonomike dhe përputhet me kërkesat e SKK 2 – <i>Paraqitja e Pasqyrave Financiare</i> .
85	Informacioni krahasues për periudhën paraardhëse duhet të jepet për të gjitha shumat e raportuara në pasqyrat financiare. Informacioni krahasues do të jepet edhe për informacionin përshkruar (narrativ), kur ai ndihmon në kuptueshmërinë e pasqyrave financiare të periudhës kontabël aktuale.
86	Kur paraqitja e informacionit ndryshon, duhet të ndryshojë gjithashtu edhe paraqitja e informacionit krahasues të periudhave kontabël paraardhëse, të paraqitura në pasqyrat financiare, me qëllim që ato të korrespondojnë me paraqitjen e re, përveç rasteve kur efekti i paraqitjes së re mbi periudhat kontabël të mëparshme, nuk mund të përcaktohet me besueshmëri.
	PËRZGJEDHJA DHE NDRYSHIMI I POLITIKAVE KONTABËL
	Përzgjedhja e politikave kontabël
87	Politikat kontabël janë parimet specifike, bazat, konvencionet, rregullat dhe praktikat e zbatuara nga një njësi ekonomike në përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare.
88	Politikat kontabël që zbatohen në përgatitjen e pasqyrave financiare, duhet të jenë në përputhje me parimet-bazë të përshkruara në Ligjin për kontabilitetin, si dhe me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit.
89	Përdorimi i politikave të papërshtatshme të kontabilitetit nuk korrigjohet as nëpërmjet përshkrimit në pasqyrat financiare të politikave kontabël të përdorura dhe as nga sqarimet e dhëna në shënimet shpjeguese.
90	Në rastet kur Standardet Kombëtare të Kontabilitetit specifikojnë një politikë kontabël të veçantë, njësia ekonomike do të zbatojë këtë politikë kontabël dhe politika e zbatuar kontabël do të shpjegohet në shënimet e pasqyrave financiare.
91	Në rastet kur Standardet Kombëtare të Kontabilitetit lejojnë zgjedhjen mes një sërë alternativash të politikave kontabël, politikat kontabël të zbatuara shpjegohen në shënimet e pasqyrave financiare.
92	Në rastet kur Standardet Kombëtare të Kontabilitetit nuk specifikojnë një politikë të caktuar kontabël, por kjo rregullohet nga një SNK/SNRF, atëherë këshillohet që të përdoret politika kontabël e përshkruar në SNK/SNRF si bazë për politikën kontabël. Megjithatë, aplikimi me zgjedhje i SKK-ve dhe SNK/SNRF-ve është i ndaluar.
93	Nëse SKK 1, nuk adreson në mënyrë specifike një transaksion, ngjarje apo rrethanë tjetër, drejtimi i një njësie ekonomike duhet të përdorë gjykimin e vet në zhvillimin dhe zbatimin e një politike kontabël që rezulton në informacion: (a) të përshtatshëm për nevojat e vendimmarrjes ekonomike të përdoruesve; dhe (b) të besueshëm, për faktin se pasqyrat financiare: (i) përfaqësojnë besnikërisht pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset e mjeteve monetare së njësisë ekonomike; (ii) përfaqësojnë thelbin ekonomik të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera, dhe jo thjesht formën ligjore; (iii) janë neutrale, dmth të lira nga paragjykimi; (iv) të matura; dhe (v) të plota në të gjitha aspektet materiale.
	Ndryshimi në politikat kontabël
94	Pasi përzgjidhet një politikë kontabël, ajo zbatohet në mënyrë të qëndrueshme vit pas viti. Politika kontabël mund të ndryshojë vetëm në rastet e mëposhtme: (a) ndryshimi i një politike kontabël kërkohet nga një SKK i ri ose i përmirësuar, ose nga Ligji “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; (b) politika e re kontabël mundëson një paraqitje më objektive të gjendjes financiare, performancës financiare të njësisë ekonomike (në përputhje me kërkesat e përshkruara në paragrafin 92) dhe fluksit të mjeteve monetare.
95	Një ndryshim në politikat kontabël do të zbatohet në retrospektivë, duke u kthyer prapa deri në fillimin e periudhës më të hershme të paraqitur, përveç rasteve kur: (a) një ndryshim në politikën kontabël ka ardhur nga një SKK i ri dhe aty janë përshkruar dispozita të ndryshme për metodën e kalimit në politikën e re, ose (b) efekti i ndryshimit të politikës kontabël, në periudhat kontabël të mëparshme, nuk mund të vlerësohet me besueshmëri.
96	Ndryshimi në politikat kontabël zakonisht zbatohet në retrospektivë, d.m.th. sikur politika e re të ishte zbatuar gjithnjë. Informacioni krahasues i periudhave kontabël të mëparshme rishihet në mënyrë të tillë që ai të jetë i paraqitur në përputhje me politikën e re kontabël. Teprica e çeljes së fitimeve të paspërndara rregullohet me qëllim që ajo të reflektojë ndryshimet për një ose më shumë periudha kontabël të mëparshme.
97	SKK të caktuara mund të lejojnë zbatimin e një politike të re kontabël në mënyrë prospektive, d.m.th. pa rregullimin e informacionit krahasues.

98	Kur është praktikisht e pamundur të përcaktohen me besueshmëri efektet e ndryshimit të një politike kontabël mbi informacionin krahasues të periudhave kontabël të mëparshme (përfshirë këtu ndikimet mbi tepricat e çeljes së periudhës së mëparshme), politika e re kontabël do të zbatohet në retrospektivë deri në fillimin e periudhës së raportimit (duke bërë kontabilizimin e efektit nga ushtrime të mëparshme, si një rregullim i tepricës së çeljes të fitimeve të pashpërndara).
	VLERËSIMET KONTABËL DHE NDRYSHIMET E TYRE
	Zbatimi i vlerësimeve kontabël
99	Disa të dhëna financiare, të paraqitura në pasqyrat financiare, bazohen në vlerësime të bëra nga drejtuesit e njësisë ekonomike dhe jo në fakte të vëzhguara në mënyrë objektive. Shembuj të zbatimit të vlerësimeve kontabël janë: (a) vlerësimi i zhvlerësimeve për kërkesat e arkëtueshme dhe inventarëve; (b) vlerësimi i jetës së dobishme të aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale, si dhe përcaktimi i normave përkatëse të amortizimit; (c) krijimi i provizioneve për shitjet me garanci ose për mbulimin e kostove që lidhen me procedurat gjyqësore në proces.
	Ndryshimet në vlerësimet kontabël
100	Një ndryshim në vlerësimin kontabël është një rregullim i vlerës kontabël neto të një aktivi ose detyrimi, ose shumës së konsumit periodik të një aktivi, që rezulton nga vlerësimi i gjendjes aktuale, përfitimeve të pritshme të ardhshme dhe detyrimeve lidhur me aktivin dhe detyrimin. Ndryshimet në vlerësimet kontabël rezultojnë prej informacionit të ri apo zhvillimeve të reja dhe, rrjedhimisht, nuk janë korrigjime të gabimeve. Kur ndryshimi në një politikë kontabël është i vështirë të dallohet nga një ndryshim në vlerësimin kontabël, ndryshimi trajtohet si një ndryshim në vlerësimin kontabël.
101	Ndryshimet në vlerësimet kontabël do të njihen gjatë periudhës kontabël kur ato kanë ndodhur dhe jo në retrospektivë.
102	Nëse një ndryshim në vlerësimin kontabël sjell lindjen e ndryshimeve në aktive dhe detyrime, ose lidhet me një zë të kapitalit, njësia duhet të rregullojë në atë masë edhe vlerën kontabël të zërit të lidhur të aktivitetit, detyrimit ose kapitalit, po në periudhën e ndryshimit.
	KORRIGJIMI I GABIMEVE
103	Gabimet janë mosraportime ose deklarime të gabuara në pasqyrat financiare të një ose më shumë periudhave kontabël, të cilat vijnë nga mospërdorimi ose keqpërdorimi i informacionit të disponueshëm nga drejtuesit gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare.
104	Gabime të tilla përfshijnë efektet e gabimeve matematikore, gabimeve në zbatimin e politikave kontabël, paqartësitë apo keqinterpretimet e fakteve, dhe mashtrimet.
105	Gabimet ndryshojnë nga ndryshimet në vlerësimet kontabël. Ndryshimet në vlerësimet kontabël bazohen në informacion të mjaftueshëm dhe të besueshëm, si dhe në ndryshimin e tij me kalimin e kohës, dhe nuk kanë të bëjë me keqpërdorimin e tij. Gabimi karakterizohet nga fakti që, ndonëse drejtuesit e njësisë ekonomike kishin informacion të mjaftueshëm e të besueshëm për të përgatitur pasqyra financiare të sakta në kohën e përgatitjes së tyre, ky informacion nuk u përdor me saktësi.
106	Gabimet materiale të periudhave kontabël të mëparshme do të korrigjohen, sipas njëres prej dy mënyrave të mëposhtme: (a) në retrospektivë, që do të thotë se shumata e korrigjimit të një gabimi material, që lidhet me periudhat kontabël të mëparshme, do të raportohet duke rregulluar tepricën e çeljes së fitimeve të pashpërndara. Informacioni krahasues duhet të riparaqitet, nëse është praktikisht e mundshme; ose (b) duke riparaqitur tepricat e çeljeve për aktivitet, detyrimet dhe kapitalin e periudhës më të hershme të mëparshme të paraqitur, në rastet kur gabimi ka ndodhur përpara periudhës më të hershme të paraqitur.
107	Gabimet jomateriale duhet të korrigjohen në periudhën kontabël aktuale. Korrigjimi i gabimeve jomateriale në retrospektivë nuk lejohet. Koncepti i materialitetit përkrahohet në paragrafët 64-68 të Standardit.
108	Nëse efekti i një gabimi material mbi informacionin krahasues të periudhave kontabël të mëparshme (përfshirë këtu tepricat e çeljes së periudhave të mëparshme) nuk mund të përcaktohen me besueshmëri, tepricat e çeljes së aktiveve, detyrimeve dhe fitimeve të pashpërndara të periudhës kontabël, për të cilën raportohet, korrigjohen për të reflektuar efektin e gabimit nga periudha kontabël të mëparshme. Kur është praktikisht e pamundur të përcaktohet me besueshmëri efekti i akumuluar i një gabimi mbi tepricat e çeljes së periudhës kontabël për të cilën raportohet, gabimi do të korrigjohet në prospektivë, që nga data më e hershme e mundshme.
	NGJARJET PAS PËRFUNDIMIT TË PERIUDHËS RAPORTUESE
109	Kontabilizimi i ngjarjeve që ndodhin pas mbylljes së periudhës raportuese, por para datës kur pasqyrat financiare autorizohen për t'u publikuar, varet nga fakti nëse këto ngjarje janë të tilla që kërkojnë rregullim ose jo.
110	Ngjarja pas periudhës raportuese për të cilën duhet të bëhen rregullime, është një ngjarje që evidenton kushte që kanë ekzistuar në datën e mbylljes së periudhës raportuese. Një njësi ekonomike duhet të rregullojë shumata e njohura në pasqyrat e saj financiare, duke përfshirë dhënien e informacioneve përkatëse shpjeguese, për të pasqyruar ngjarjet rregulluese pas përfundimit të periudhës raportuese.

111	Ngjarjet pas fundit të periudhës së raportimit përfshijnë të gjitha ngjarjet deri në datën kur pasqyrat financiare autorizohen për publikim edhe nëse këto ngjarje ndodhin pas deklarimit publik të fitimit ose humbjes ose informacioneve të tjera të përzgjedhura financiare.
112	Ngjarjet, për të cilat nuk bëhen rregullime janë ngjarjet që evidentojnë kushtet që nuk kanë ekzistuar para mbylljes së periudhës raportuese. Njësia ekonomike nuk do të korrigjojë shumat e njohura në pasqyrat e saj financiare për të reflektuar ngjarjet për të cilat nuk bëhen rregullime, pas përfundimit të periudhës raportuese. Efekti i ngjarjeve për të cilat nuk bëhen rregullime do të përshkruhet në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare nëse ato janë materiale.
	Deklarimi i dividendëve pas përfundimit të periudhës raportuese
113	Nëse një njësi ekonomike u deklaron dividendët mbajtësve të instrumentave të kapitalit neto të saj, pas përfundimit të periudhës raportuese por përpara autorizimit për publikim të pasqyrave, njësia ekonomike nuk do t'i njohë këto dividendë si një detyrim në fund të periudhës raportuese. Shuma e dividendit mund të paraqitet si një komponent i ndarë nga fitimet e pashpërndara në fund të periudhës raportuese.
	SHËNIMET SHPJEGUESE
114	Njësia ekonomike duhet të paraqesë në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare një përmbledhje të politikave kryesore kontabël, të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare.
115	Në rastet kur një ndryshim i këtij Standardi ndikon në periudhën aktuale ose ndonjë periudhë të mëparshme, apo mund të ketë një efekt në periudhat e ardhshme, njësia ekonomike duhet të japë informacionin shpjegues në vijim: (a) llojin e ndryshimit në politikën kontabël; (b) për periudhën aktuale dhe çdo periudhë të mëparshme të paraqitur, deri në masën e mundshme, shumën e rregullimit për çdo zë të prekur të pasqyrave financiare; (c) shumën e rregullimit që lidhet me periudhat para atyre të paraqitura, për aq sa është e zbatueshme; (d) një shpjegim në rastet kur është i pazbatueshëm përcaktimi i shumave të deklaruara në (b) ose (c) më sipër; Pasqyrat financiare të periudhave të mëpasshme nuk duhet të përsërisin këto informacione shpjeguese.
116	Në rastet kur një ndryshim i vullnetshëm në politikën kontabël ndikon në periudhën aktuale ose në ndonjë periudhë të mëparshme, njësia ekonomike duhet të japë informacionin shpjegues në vijim: (a) llojin e ndryshimit në politikën kontabël; (b) arsyet se përse zbatimi i politikës së re kontabël siguron informacion të besueshëm dhe më të përshtatshëm; (c) për aq sa është e zbatueshme, shumën e rregullimit për çdo zë të prekur të pasqyrave financiare, treguar veçmas: (i) për periudhën aktuale; (ii) për secilën periudhë të mëparshme të paraqitur; dhe (iii) në total për periudhat para atyre të paraqitura.
117	Nëse mënyra e paraqitjes së politikave kontabël dhe/ose informacionit kontabël ka ndryshuar, atëherë në shënimet shpjeguese do të shpjegohet: (a) përshkrimi i ndryshimit dhe arsyeja e ndryshimit; (b) efekti i tij mbi zërat e pasqyrës së pozicionit financiar dhe pasqyrës së performancës financiare; (c) nëse ndryshimi nuk është njohur në retrospektivë, do të jepet shpjegimi i situatës, përshkrimi i efektit të politikës së re, si dhe ushtrimet e mëparshme të ndikuara nga ndryshimi.
118	Në ato raste kur, për hir të një paraqitje sa më të vërtetë e të besueshme, dispozitat e disa Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit nuk janë zbatuar, atëherë në shënimet shpjeguese do të shpjegohet: (a) dispozita e SKK-së që nuk është ndjekur; (b) arsyeja për mosndjekjen e saj; (c) efekti mbi zërat e pasqyrës së pozicionit financiar dhe të pasqyrës së performancës financiare.
119	Njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese mbi llojin e çdo ndryshimi në vlerësimin kontabël dhe efektin e ndryshimit në aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën aktuale. Nëse njësia ekonomike mund të vlerësojë efektin e ndryshimit në një ose më shumë periudha të ardhshme, atëherë duhet të japë informacione shpjeguese për këto vlerësime.
120	Kur zbulohen gabime materiale nga periudhat e mëparshme, në shënimet shpjeguese do të jepet sa vijon: (a) llojin e gabimit në periudhat e mëparshme; (b) për çdo periudhë të mëparshme të paraqitur, për aq sa është praktike, shumën e rregullimit për çdo zë të prekur të pasqyrave financiare; (c) për aq sa është praktike, shumën e rregullimit në fillim të periudhës më të hershme të paraqitur; (d) një shpjegim në rastet kur nuk është praktike të përcaktohen shumat e shpalosura sipas (b) ose (c) më sipër. Pasqyrat financiare të periudhave të mëpasshme nuk duhet të përsërisin këto dhënie informacioni shpjeguese

	Data e autorizimit për publikim	
121	Një njësi ekonomike jep informacion rreth datës kur janë autorizuar për publikim pasqyrat financiare dhe kush e ka dhënë autorizimin. Nëse pronarët ose persona të tjerë të njësisë ekonomike kanë kompetenca për të ndryshuar pasqyrat financiare pas publikimit, njësia ekonomike do të japë informacion rreth këtij fakti.	
122	Njësia ekonomike duhet të japë informacionet e mëposhtme shpjeguese për çdo kategori ngjarjeje pas përfundimit të periudhës raportuese, që nuk mund të rregullohet: (a) llojin e ngjarjes; (b) një vlerësim të efektit të saj financiar; (c) një deklaratë që një vlerësim i tillë nuk mund të bëhet.	
123	Nëse ka pasiguri në lidhje me vazhdimësinë e veprimtarisë së njësisë ekonomike, në shënimet shpjeguese duhet të jepen faktorët që shkaktojnë këtë pasiguri. Nëse pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e likuidimit të operacioneve të njësisë ekonomike, atëherë do të shpjegohet arsyeja dhe baza e përgatitjes.	
	DATA E HYRJES NË ZBATIM	
124	SKK 1 <i>Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare</i> , përditësuar në vitin 2023, do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudha kontabël që fillojnë më ose pas datës 01.01.2025. Kërkesat e SKK 1 (2023) do të zbatohen në prospektivë.	
	TABELA KRAHASUESE	
125	Tabela më poshtë tregon se si korrespondojnë paragrafët e këtij Standardi me SNRF për NVM (2015). Paragrafët janë konsideruar si korresponduese nëse ato trajtojnë në përgjithësi të njëjtën çështje pavarësisht nga fakti që seksionet e referuara mund të kenë ndryshime.	
	Paragrafët e SKK 1	Paragrafët e SNRF për NVM botuar në korrik 2015
	Paragrafi 1	Asnjë
	Paragrafi 2	Asnjë
	Paragrafi 3	Asnjë
	Paragrafi 4	Asnjë
	Paragrafi 5	Sek 2.2
	Paragrafi 6	Asnjë
	Paragrafi 7	Asnjë
	Paragrafi 8	Sek 2.15
	Paragrafi 9	Sek 2.16
	Paragrafi 10	Sek 2.23
	Paragrafi 11	Sek 2.24
	Paragrafi 12	Asnjë
	Paragrafi 13	Asnjë
	Paragrafi 14	Sek 2.17
	Paragrafi 15	Sek 2.18
	Paragrafi 16	Sek 2.19
	Paragrafi 17	Sek 2.37
	Paragrafi 18	Sek 2.38
	Paragrafi 19	Asnjë
	Paragrafi 20	Sek 2.21
	Paragrafi 21	Sek 2.20
	Paragrafi 22	Sek 2.39
	Paragrafi 23	Sek 2.40
	Paragrafi 24	Sek 2.22
	Paragrafi 25	Asnjë
	Paragrafi 26	Asnjë
	Paragrafi 27	Sek 2.25

Paragrafi 28	Sek 2.41
Paragrafi 29	Asnjë
Paragrafi 30	Sek 2.26
Paragrafi 31	Sek 2.42
Paragrafi 32	Asnjë
Paragrafi 33	Sek 2.43
Paragrafi 34	Sek 2.44
Paragrafi 35	Sek 2.45
Paragrafi 36	Sek 2.35
Paragrafi 37	Sek 2.36
Paragrafi 38	Asnjë
Paragrafi 39	Asnjë
Paragrafi 40	Asnjë
Paragrafi 41	Asnjë
Paragrafi 42	Asnjë
Paragrafi 43	Asnjë
Paragrafi 44	Sek 2.27
Paragrafi 45	Sek 2.28
Paragrafi 46	Sek 2.29
Paragrafi 47	Sek 2.30
Paragrafi 48	Sek 2.31
Paragrafi 49	Sek 2.32
Paragrafi 50	Asnjë
Paragrafi 51	Sek 2.33
Paragrafi 52	Sek 2.34
Paragrafi 53	Asnjë
Paragrafi 54	Sek 2.46
Paragrafi 55	Sek 2.47
Paragrafi 56	Sek 2.49
Paragrafi 57	Sek 2.51
Paragrafi 58	Sek 2.52
Paragrafi 59	Sek 2.52
Paragrafi 60	Asnjë
Paragrafi 61	Sek 2.4
Paragrafi 62	Asnjë
Paragrafi 63	Asnjë
Paragrafi 64	Sek 2.5, Sek 2.6
Paragrafi 65	Sek 2.5, Sek 2.6
Paragrafi 66	Sek 2.5, Sek 2.6
Paragrafi 67	Sek 2.5, Sek 2.6
Paragrafi 68	Sek 10.3
Paragrafi 69	Sek 2.7

Paragrafi 70	Asnjë
Paragrafi 71	Sek 2.8
Paragrafi 72	Asnjë
Paragrafi 73	Asnjë
Paragrafi 74	Sek 2.9
Paragrafi 75	Asnjë
Paragrafi 76	Sek 2.10
Paragrafi 77	Sek 2.12
Paragrafi 78	Sek 10.7
Paragrafi 79	Sek 2.11
Paragrafi 80	Sek 2.13
Paragrafi 81	Sek 2.14A
Paragrafi 82	Sek 2.14B
Paragrafi 83	Asnjë
Paragrafi 84	Asnjë
Paragrafi 85	Asnjë
Paragrafi 86	Asnjë
Paragrafi 87	Sek 10.2
Paragrafi 88	Asnjë
Paragrafi 89	Asnjë
Paragrafi 90	Asnjë
Paragrafi 91	Asnjë
Paragrafi 92	Sek 10.6
Paragrafi 93	Sek 10.4
Paragrafi 94	Sek 10.8
Paragrafi 95	Sek 10.11
Paragrafi 96	Sek 10.12
Paragrafi 97	Asnjë
Paragrafi 98	Sek 10.12
Paragrafi 99	Asnjë
Paragrafi 100	Sek 10.15
Paragrafi 101	Sek 10.16
Paragrafi 102	Sek 10.17
Paragrafi 103	Sek 10.19
Paragrafi 104	Sek 10.20
Paragrafi 105	Asnjë
Paragrafi 106	Sek 10.21
Paragrafi 107	Asnjë
Paragrafi 108	Sek 10.22
Paragrafi 109	Sek 32.2
Paragrafi 110	Sek 32.2, Sek 32.4
Paragrafi 111	Sek 32.3

Paragrafi 112	Sek 32.2, Sek 32.6
Paragrafi 113	Sek 32.8
Paragrafi 114	Asnjë
Paragrafi 115	Sek 10.13
Paragrafi 116	Sek 10.14
Paragrafi 117	Asnjë
Paragrafi 118	Asnjë
Paragrafi 119	Sek 10.18
Paragrafi 120	Sek 10.23
Paragrafi 121	Sek 32.9
Paragrafi 122	Sek 32.10
Paragrafi 123	Asnjë
Paragrafi 124	Asnjë
Paragrafi 125	Asnjë